

VENDIM
Nr. 36, datë 24.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (Sh) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shtjefën Lleshi

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Lartë Gjyqësor

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 6/1/1/1/1/1/1/1/1, datë 17.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuës me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 42, 140 dhe 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 172, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*); neni 100, pika 1, i ligjit nr. 115/2016, datë 3.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Shtjefën Lleshi, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillin të Lartë Gjyqësor, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Shtjefën Lleshi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë prej vitit 1993, ndërsa përgjatë periudhës prill 2008–dhjetor 2013 ka mbajtur pozicionin e kryetarit të kësaj gjykate.

2. Në datat 26–29 nëntor 2013, në një emision televiziv, janë publikuar regjistrime audiovizive që përmbanin të dhëna për përfshirje në akte korruptive të disa punonjësve të administratës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të kryera në ambientet e gjykatës, të dhëna të cilat kanë krijuar dyshimin për përfshirjen edhe të kërkuarit në këto veprime korruptive. Për pasojë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*KLD*), me vendimin nr. 402, datë 3.12.2013, ka vendosur lirimin e kërkuarit nga funksioni i kryetarit të gjykatës.

3. Gjithashtu, me vendimin nr. 404, datë 3.12.2013 (*vendimi nr. 404/2013*), KLD-ja ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të përbashkët me inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Shtjefën Lleshi dhe të administratës gjyqësore të asaj gjykate për ankesën e bërë publike nga emisioni televiziv, për shkelje të etikës dhe mosrespektim formal të ligjit në shqyrtimin e çështjeve të përmendura në atë emision.

4. Njëkohësisht ndaj kërkuarit ka filluar edhe procedimi penal, në kuadër të të cilit, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1496, datë 12.12.2013, ka vendosur masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, masë që ka ndryshuar në datën 8.1.2014, në “Arrest në shtëpi”. Për këtë shkak, KLD-ja, bazuar në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 9877/2008*), me vendimin nr. 406, datë 16.12.2013, ka vendosur pezullimin nga detyra të kërkuarit deri në marrjen e vendimit të formës së prerë për procedimin penal ndaj tij.

5. Ministri i Drejtësisë, mbështetur në rezultatet e inspektimit të përbashkët të ushtruar në përmbushje të vendimit nr. 404/2013 dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht të nenit 34 të ligjit nr. 9877/2008 dhe nenit 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8811/2001*), me shkresën nr. 513/4 prot., datë 16.5.2014, ka kërkuar procedimin disiplinor ndaj kërkuarit dhe i ka propozuar KLD-së caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

6. KLD-ja, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës, ligjin nr. 8811/2001 dhe ligjin nr. 9877/2008, me vendimin nr. 100, datë 16.7.2014 (*vendimi nr. 100/2014*), ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkuarit, pasi ka konkluduar se veprimet e tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore përbënin akte dhe sjellje që diskreditonin shumë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, duke përbërë shkelje shumë të rënda të disiplinës, të tilla që çonin në shkarkimin e tij nga detyra. Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit, në përputhje me përcaktimin e nenit 147, pika 6, të Kushtetutës dhe nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 9877/2008, është shënuar: “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Lartë, brenda 15 ditëve nga njoftimi i tij”.

7. Kërkuari, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankim kundër vendimit të KLD-së nr. 100/2014. Ky ankim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 17.10.2014. Nëpërmjet ankimit kërkuari ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ/vendimit të shkarkimit nga detyra, kthimin në detyrën e mëparshme të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe detyrimin e KLD-së për dhënien e pagës nga dita e vendimarrjes së shkarkimit.

8. Paralelisht me procesin administrativ ndaj kërkuarit ka vazhduar edhe procesi penal, në përfundim të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 680 (4755), datë 22.12.2014, e ka shpallur fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 481, datë 23.12.2015, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1063, datë 8.10.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit dhe kërkuarit.

9. Gjatë kohës që pritej shqyrtimi i rekurseve ndaj vendimit penal të dënimit, me shkresën nr. 6/1 akti, datë 15.3.2016, Gjykata e Lartë ka njoftuar kërkuarin se Kolegjet e Bashkuara do të mbledheshin në seancë gjyqësore publike në datën 4.4.2016 për shqyrtimin e ankesës së tij ndaj vendimit nr. 100/2014 të KLD-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.4.2016, kanë vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuarit të regjistruar pranë saj me nr. 0388/2016.

10. Ndërsa çështja administrative ishte pezulluar në Gjykatën e Lartë, në datën 22.7.2016 Kuvendi i Shqipërisë miraton ligjin nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417,

datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 76/2016*), i cili krijoi organe të reja, sikurse Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD), Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA), të cilat tashmë kishin tagrin kushtetues respektiv për fillimin e procedimit disiplinor, vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe shqyrtimin e ankimeve ndaj këtyre vendimeve. Në vijim, ligjvënësi, në datat 6.10.2016 dhe 3.11.2016, miraton përkatësisht ligjet nr. 96/2016 dhe nr. 115/2016, nëpërmjet të cilave, ndër të tjera, u detajua procedura administrative për dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Në dispozitat kalimtare të këtyre ligjeve janë përcaktuar rregullime të posaçme për periudhën tranzitore deri në krijimin e organeve kompetente, përfshirë edhe vijueshmërinë e procedimeve disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.

11. Pas miratimit të këtyre akteve ligjore u krijuan dhe filluan funksionimin të tria institucionet kushtetuese të sipërcituara. Konkretisht, KPA-ja filloi funksionimin në vitin 2017, KLGJ-ja në vitin 2018 dhe ILD-ja në vitin 2020.

12. Me dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ndaj vendimit penal të dënimit të kërkuesit, me shkresën nr. 6/1 akti, datë 28.2.2022, kjo gjykatë ka njoftuar kërkuesin dhe organin administrativ disiplinor (ish-KLD-në/sot KLGJ-në) për shqyrtimin e ankimit të kërkuesit ndaj vendimit të KLD-së nr. 100/2014 në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi pa praninë e palëve në datën 17.3.2022, duke i bërë me dije edhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Administrativ.

13. Me vendimin nr. 6/1/1/1/1/1/1/1/1, datë 17.3.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës ankimore të kërkuesit me arsyetimin se ajo ishte e pabazuar në ligj. Sipas këtij kolegji, me përfundimin e procesit penal për dënimin e kërkuesit kishte rënë shkaku i pezullimit të procesit administrativ dhe si legjislacioni në fuqi, në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes, ashtu edhe ai aktual, diktojnë papajtueshmërinë e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në rastin e dënimit të tij me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

14. Në datën 7.7.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

15. Me vendimin nr. 13, datë 19.9.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarë të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

16. Kolegji i Gjykatës në datën 21.9.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

17.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga tre anëtarë, ka dhënë një vendim absolutisht të pavlefshëm, në kushtet kur i mungon legjitimiteti dhe juridiksioni për të gjykuar rastin konkret. Përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 ankesat e gjyqtarëve ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore nga KLD-ja shqyrtoheshin nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa pas ndryshimeve nga Gjykata Kushtetuese dhe përkohësisht nga KPA-ja.

17.2. *Së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka njoftuar as kërkuesin, as mbrojtësin e tij, me asnjë mjet komunikimi, lidhur me zhvillimin e gjykimit dhe dhënien e vendimit, duke i pamundësuar atij pjesëmarrjen dhe ushtrimin e çdo kërkimi të ligjshëm. Për më

tepër, në këtë rast, Gjykata e Lartë ka gjykuar vendimin e KLD-së në nivel të dytë gjykimi dhe e ka trajtuar ankimin si një rekurs të zakonshëm.

18. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

18.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i bazuar, pasi me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, konkretisht sipas parashikimeve të bëra në nenet 140, pika 4 dhe 179, pika 7, të Kushtetutës, shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve i ka kaluar juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe për një periudhë kalimtare KPA-së, që funksionon si kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese. Po kështu, sipas ndryshimit të bërë në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, ndërsa Kolegjet e Bashkuara të saj, që më herët vendosnin për vendimin e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit (neni 147, pika 6), tashmë shqyrtojnë vetëm çështje për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Edhe në pikëpamje të kompetencës funksionale, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes së kërkuarit. Arsyeja e këtij kolegji, referuar nenit 41 të KPC-së, nuk qëndron, pasi, së pari, ky kolegji, si para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ashtu edhe pas këtyre ndryshimeve, në asnjë rast nuk e ka pasur kompetencën për të shqyrtuar rastet e shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve nga KLD-ja ose KLGJ-ja, si organi aktual kompetent që ka zëvendësuar KLD-në. Së dyti, referuar vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, gjykatat administrative, përfshirë edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, janë kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 dhe shqyrtimi i tyre nuk ka përfunduar ende. Në këto kushte, KLGJ-ja nuk mund të shprehet për mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes nga ajo gjykatë në këtë moment.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

20. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e tjera ligjore për shqyrtimin e kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

21. Gjykata çmon se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë. Po kështu, ai ka shteruar *mjetet juridike efektive në dispozicion*, pasi ka kundërshtuar me ankim kushtetues individual vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të inicuar prej tij për të kundërshtuar vendimin e shkarkimit nga detyra. Gjithashtu, ankimi është regjistruar në datën 7.7.2022, pra brenda afatit 4 - mujor nga dhënia e vendimit të kundërshtuar në datën 17.3.2022, në përputhje me përcaktimin e nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.

8577/2000. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimi që lidhet me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe të drejtave të aksesit dhe për t'u dëgjuar, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim ajo do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

22. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë vetëm nga tre anëtarë, ka dhënë një vendim absolutisht të pavlefshëm, në kushtet kur i mungon legjitimiteti dhe juridiksioni për të gjykuar rastin konkret. Referuar legjislacionit përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ankesat e gjyqtarëve ndaj vendimeve të KLD-së për dhënien e masave disiplinore shqyrtoheshin nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me përbërje të plotë, ndërsa pas ndryshimeve, ato shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese dhe përkohësisht nga KPA-ja. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenet 140, pika 4 dhe 179, pika 7, të Kushtetutës, nenin 172, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 100 të ligjit nr. 115/2016.

23. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se e konsideron të drejtë pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, konkretisht sipas parashikimeve të bëra në nenet 140, pika 4 dhe 179, pika 7, të Kushtetutës, shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve i ka kaluar juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe për një periudhë kalimtare KPA-së, që funksionon si kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese. Po kështu, sipas ndryshimit të bërë në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, ndërsa Kolegjet e Bashkuara të saj, që më herët vendosnin për vendimin e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit (neni 147, pika 6), tashmë shqyrtojnë vetëm çështje për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Edhe në pikëpamje të kompetencës funksionale, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka një kompetencë të tillë për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit. Arsyeimi i këtij kolegji, referuar nenit 41 të KPC-së, nuk qëndron, pasi, së pari, ky kolegji, si para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ashtu edhe pas këtyre ndryshimeve, në asnjë rast nuk e ka pasur kompetencën për të shqyrtuar rastet e shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve nga KLD-ja ose KLGJ-ja, si organi aktual kompetent që ka zëvendësuar KLD-në. Së dyti, referuar vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, gjykatat administrative, përfshirë edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, janë kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 dhe shqyrtimi i tyre nuk ka përfunduar ende. Në këto kushte, KLGJ-ja nuk mund të shprehet për mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes nga ajo gjykatë në këtë moment.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura prej saj dhe nga ligji nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo për mbrojtjen e tyre, ose në rastin e akuzave të ngritura ndaj tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një

gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 17.3.2022 ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuarit ndaj vendimit të KLD-së që ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra, të regjistruar në atë gjykatë në datën 17.10.2014. Kolegji Administrativ e ka argumentuar ushtrimin e kësaj kompetence duke u shprehur se “[...] pavarësisht rregullimeve të reja kushtetuese dhe ligjore të cilat nuk i atribuojnë më Gjykatës së Lartë juridiksion fillestar gjykimi, për kërkesat e regjistruara pranë saj, në kohën kur gjykata gëzonte juridiksion fillestar dhe ende të patrajtuara me vendim përfundimtar, siç është rasti objekt gjykimi, Gjykata e Lartë duhet të vijoj gjykimin e çështjes. Ky përfundim mbështetet edhe në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, neni 36 pika 4 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet: ‘Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëposhme të faktit apo të ligjit’, gjithashtu edhe në nenin 41 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet: ‘Kompetenca përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëposhme të faktit ose të ligjit.’” (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

27. Gjykata, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, evidenton se në vitin 2016 kanë ndodhur ndryshime kushtetuese, ligjore dhe institucionale, të cilat kanë ridimensionuar mënyrën e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, duke përcaktuar edhe fushën dhe kompetencat e tyre. Po kështu, këto ndryshime kanë prekur edhe juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim çështjen dhe e ka zgjidhur atë duke u mbështetur në nenet 36 dhe 41 të KPC-së, të cilat e lidhin juridiksionin dhe kompetencën lëndore me momentin e paraqitjes së padisë - pavarësisht ndryshimeve të mëposhme të faktit ose të ligjit, Gjykata çmon që paraprakisht të analizojë kuadrin kushtetues dhe ligjor në raport me kohën e procedimit disiplinor (viti 2013), dhënien e masës disiplinore (viti 2014), ankimin kundër vendimit të shkarkimit nga detyra (viti 2014), pezullimin e shqyrtimit të ankimit nga Kolegjet e Bashkuara (viti 2016 - para ndryshimeve kushtetuese) dhe kohën e shqyrtimit të ankimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (viti 2022).

28. Kushtetuta në nenin 147, pika 6, fjalía e fundit (para ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016) parashikonte se vendimet e KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit ankimohen në Gjykatën e Lartë, e cila vendos me Kolegje të Bashkuara. Ky parashikim kushtetues ishte reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 34 të ligjit nr. 8811/2001 dhe nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 9877/2008, sipas të cilëve ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra gjyqtari kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë, që vendoste me Kolegje të Bashkuara.

29. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 është riformuluar neni 140 i Kushtetutës, i cili në pikën 4 ka përcaktuar se kundër vendimit të shkarkimit gjyqtari mund të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregullim kushtetues është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës. Ndërkohë, për një periudhë të përkohshme kjo kompetencë i ka kaluar KPA-së, sipas nenit 179, pika 7, fjalía e dytë, po të Kushtetutës. Ky parashikim kushtetues është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 5, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit KPA-ja, gjatë mandatit të saj, ka juridiksion të shqyrtojë edhe ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.

30. Po kështu, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 është reformuar kompetenca e Gjykatës së Lartë dhe konkretisht e Kolegjeve të Bashkuara, pasi tashmë kjo e fundit shqyrton çështje të caktuara gjyqësore për ndryshimin e praktikës gjyqësore (neni 141, pika 2). Ky parashikim kushtetues është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 32 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit

gjqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore (pika 1). Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi (pika 2).

31. Në kontekst të sa më sipër, Gjykata evidenton se para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve ndaj vendimeve të KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve përfshiheshin në juridiksionin gjyqësor (fillestar) të Gjykatës së Lartë, ku kompetenca lëndore dhe ajo funksionale për shqyrtimin e tyre u përkiste Kolegjeve të Bashkuara të saj. Ndërsa pas ndryshimeve të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve kundër vendimeve disiplinore në përgjithësi ndaj gjyqtarëve, përfshirë edhe për shkarkimin e tyre nga detyra, u përfshinë në juridiksionin kushtetues, duke i kaluar kështu juridiksioni gjyqësor për këto çështje Gjykatës Kushtetuese dhe për një periudhë të përkohshme një prej kolegjeve të kësaj gjykate (KPA-së).

32. Thënë ndryshe, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, Gjykatës së Lartë i është hequr e drejta për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e ngritura mbi ankimet kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve, duke rënë për pasojë edhe kompetenca e saj lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese, gjatë periudhës kalimtare të ushtrimit të mandatit nga KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të këtij mandati kushtetues ky juridiksion do të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese.

33. Nga ana tjetër, Gjykata evidenton se KPA-ja si organ kushtetues dhe kolegji i Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b, pika 5, fjalia e dytë, i Kushtetutës), edhe pse me kompetenca të veçanta, ofron të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, ajo vepron në përputhje me parimet e kushtetutshmërisë dhe procesit të rregullt. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 67, datë 11.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këtë drejtim, Gjykata e vlerëson të drejtë prapësimin e subjektit të interesuar, KLGJ-së, se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë ndonjëherë gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit të gjyqtarit ndaj vendimit të KLD-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit, as para ndryshimeve, as pas ndryshimeve të vitit 2016. Në rastin konkret, ankimi i kërkuarit ndaj vendimit të KLD-së është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 17.10.2014, që do të thotë se juridiksioni dhe kompetenca e shqyrtimit të tij në atë kohë i takonte Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në cilësinë e juridiksionit fillestar, por referuar legjislacionit aktual, prej vitit 2016 shqyrtimi i një ankese të tillë nuk është më në juridiksionin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por në juridiksionin gjyqësor disiplinor të KPA-së.

35. Gjykata gjithashtu, sjell në vëmendje se zbatimi në kohë i ligjit procedural, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe më parë se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit

kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009; nr. 106, datë 27.5.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkesit për cenimin e parimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, është i bazuar. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson mos të ndalet në analizimin e pretendimeve të kërkesit që lidhen me cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar, për sa kohë që ankimi i tij do të merret në shqyrtim nga organi kompetent.

37. Në përfundim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar dhe çështja objekt gjykimi t'i dërgohet për shqyrtim organit kompetent në juridiksion të të cilit ajo përfshihet, pra KPA-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 6/1/1/1/1/1/1/1, datë 17.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë, më 24.11.2022.
Shpallur, më 19.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha,

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Fiona Papajorgji